



**PROTECTING NATURE FOR  
A SUSTAINABLE FUTURE**  
IMPROVING THE MANAGEMENT OF PROTECTED AREAS



**KOMUNA E GOSTIVARIT  
ОПШТИНА ГОСТИВАР  
MUNICIPALITY OF GOSTIVAR  
GOSTIVAR BELEDIYE**



**KLUBI SPELEOLOGJIK KORABI  
СПЕЛЕОЛОШКИ КЛУБ КОРАБИ  
KORABI SPELEOLOGICAL CLUB**

### **Shpallja:**

#### **Trajnim për hulumtim dhe eksplorim speleologjik**

Projekti për 'Përmirësimin e menaxhimit me zonat e mbrojtura' financohet nga Bashkimi Evropian ndërsa implementohet nga ana e Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara në bashkëpunim me Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor. Pas grantit të nënshkruar ndërmjet UNDP dhe KS Korabi, Projekti i titulluar:

**"Fuqizimi i aktorëve lokalë për eksplorimin, hulumtim dhe konservim të trashëgimisë natyrore të shpellës Bukuroshja"** zbatohet nga Klubi i Speleologëve KORABI në partneritet me Komunën e Gostivarit.

Projekti është i orientuar drejt ruajtjes, konservimit dhe monitorimit të monumentit natyror të shpellës Bukuroshja, që ndodhet në fshatin Gjonovicë, Komuna e Gostivarit.

Në aplikacionin e projektit është paraparë edhe Trajnimi tematik që synon përmirësimin e shkathtësive të speleologëve lokalë, ndërsa njëherit projekti ka për qëllim forcimin e kapaciteteve të popullatës lokale, institucioneve dhe shoqatave lokale të qytetarëve për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore, përkatësisht mbrojtjen e monumentit të natyrës - Shpella Bukuroshja në fshatin Gjonovicë.

Për realizimin e një pjese të aktiviteteve të projektit, KS KORABI dhe Komuna e Gostivarit shpallin Thirrjen për trajnim të gjashtë speleologëve lokalë.



Trajnimi do të implementohet në gjysmën e dytë të Gushtit 2018.

Kandidatët e interesuar për trajnim do të kontaktohen dhe intervistohen nga ana e ekipit të projektit.

Prej kandidatëve të paraqitur do të përzgjidhen gjashtë (6) persona.

Gjatë trajnimit, atyre do tu mbulohen shpenzimet e udhëtimit dhe ushqimit.

Trajnimi përbëhet nga pjesa teorike dhe praktike.

Përmbajtja e trajnimit tematik:

- Gjeologjia e shpellave dhe speleogjenezës
- Speleogjeneza: Efektet kimike dhe fizike që janë involvohen në formimin e shpellave natyrore
- Rrjedha natyrore e ujërave nëntokësore: studime për modelim dhe shpella
- Jeta në shpella
- Jeta mikrobike në shpella (për monitorim)
- Praktika të mira në lokalitetet arkeologjike. Speleoarkeologjia lokale: ngjarjet aktuale, perspektivat dhe metodat
- Teknikat kërkimore speleologjike
- Materialet teknike speleo-alpinistike

- Ndihma e parë dhe shpëtimi në shpella

Pjesa teorike përfshin mësimdhënie dhe prezantime rreth speleologjisë, ndërsa pjesa praktike do të organizohet Qendrën për trajnim në fshatin Vërtok dhe duke përfshirë kandidatët në shpellën Bukuroshja në fshatin Gjonovicë. Personat e përfshirë në këtë trajnim do të marrin Certifikatë ndërkombëtare për përfundimin e trajnimit speleologjik.

Kandidatët e interesuar mund të aplikojnë në emailin e mëposhtëm:

speleo.korabi@hotmail.com; info@gostivari.gov.mk

informata plotësuese në telefonat e kontaktit: 072 277 726 ; 070 523 872; 071 306 424; 042 213 511

me dorëzim të të dhënave të mëposhtme:

- emri dhe mbiemri,

- viti i lindjes,

- arsimi i kryer;

Kriteret për aplikim:

- Mosha mbi 18 vjeç

- Adresa e banimit: Komuna e Gostivarit

- (Përparësia) Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve të tjera të huaja

Afati i paraqitjes është deri më datë 06.08.2015.

